RAPORTI I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	
EMËRTIMI I PROPOZIMIT TË POLITIKËS	Projektligj "Për një ndryshim në ligjin nr. 73/2021, "Për hedhjen në treg dhe mbikëqyrjen e artikujve piroteknikë".
MINISTRIA UDHËHEQËSE	Ministria e Mbrojtjes
FAZA E POLITIKËS/VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	Finale
BURIMI I PROPOZIMIT TË POLITIKËS	I brendshëm
DIREKTIVË/RREGULLORE E BE-së	Jo e zbatueshme
PUBLIKIMET DHE STRATEGJITË E LIDHURA	Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Evropian 2022–2030. Strategjia Ndërsektoriale për Reformën në Administratën Publike 2024–2030. Strategjia Kombëtare për Kontrollin e Armëve të Vogla, të Lehta, Municioneve dhe Eksplozivëve. Procesi i Integrimit Evropian, Kapitulli 1 "Lëvizja e lirë e mallrave". Strategjia Kombëtare për Menaxhimin e Financave Publike 2023–2030.
DATA E KONSULTIMIT PUBLIK	06.10.2026-03.11.2026
DATA E VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	06/11/2026
A E KA SHQYRTUAR KRYEMINISTRIA VLERËSIMIN E NDIKIMIT? **NËSE PO, JEPNI DATËN E SHQYRTIMIT**	Po 06/10/2026
NUMRI I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	2026 – MM- Nr. 5
TE DHËNA KONTAKTI (EMRI, E-MAIL, NUMRI I TELEFONIT TË PERSONIT TË KONTAKTIT)	Eltiona Metani e-mail: eltiona.metani@akshe.gov.al Tel: 0682094180

PJESA 1: PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE (maksimumi 2 faqe)

PËRKUFIZIMI I PROBLEMIT

Cili është problemi në shqyrtim dhe cilat janë shkaqet e tij? Pse është e nevojshme ndërhyrja qeverisë?

Problemi kryesor qëndron në mungesën e bazës ligjore në ligjin nr. 73/2021 për përcaktimin dhe mbledhjen e tarifave administrative për shërbimet e licencimit dhe autorizimit të ofruara nga AKSHE. Megjithëse këto shërbime përfshijnë veprimtari administrative dhe teknike me kosto të

matshme, ligji nuk parashikon mekanizmin që këto kosto të mbulohen nga përfituesit e shërbimit. Për rrjedhojë, ato përballohen tërësisht nga buxheti i institucionit.

Shkaqet

Shkaku rrënjësor i problemit është mungesa e një dispozite autorizuese në ligjin nr. 73/2021, e cila të mundësojë përcaktimin dhe mbledhjen e tarifave për shërbimet e licencimit dhe autorizimit. Si shkak dytësor identifikohet mosreflektimi në ligjin e ri i regjimit tarifor të mëparshëm, të parashikuar në Urdhrin e Ministrit të Mbrojtjes nr. 155, datë 21.03.2005, i ndryshuar, si dhe mungesa e një metodologjie të miratuar për llogaritjen e kostove administrative. Gjatë hartimit të ligjit nr. 73/2021, çështja e tarifave dhe vijimësia e regjimit të mëparshëm nuk u trajtuan në mënyrë të posaçme. Ndërkohë, nuk janë konstatuar ndryshime të tjera institucionale apo procedurale pas vitit 2021 që të kenë ndikuar në krijimin e problemit.

Pasojat

Mungesa e mekanizmit të tarifimit sjell përballimin e plotë të kostove administrative nga buxheti i AKSHE-së, duke kufizuar burimet financiare të disponueshme për ushtrimin e funksioneve të tjera institucionale, veçanërisht mbikëqyrjen dhe kontrollin. Gjithashtu, krijon një trajtim të ndryshëm financiar të të njëjtit shërbim krahasuar me periudhën para vitit 2021, pasiguri juridike për administratën dhe operatorët ekonomikë, si dhe pamundësi për miratimin e një VKM-je që përcakton tarifat pa një bazë ligjore autorizuese. Mungesa e një metodologjie të standardizuar pengon gjithashtu përcaktimin transparent të tarifave në përputhje me kostot reale të shërbimeve.

Grupet e prekura

Grupet e prekura nga ky problem janë AKSHE-ja, e cila përballon kostot administrative dhe teknike të shërbimeve pa mundësi rikuperimi nëpërmjet tarifave; Ministria e Mbrojtjes, në rolin e saj institucional dhe koordinues në këtë fushë; si dhe operatorët ekonomikë, të cilët përballen me mungesën e një mekanizmi të qartë dhe transparent tarifor. Në mënyrë të tërthortë preken edhe institucionet bashkëpunuese, të përfshira në proceset e koordinimit dhe verifikimit të aplikimeve, si dhe qytetarët, për shkak të përdorimit të burimeve publike për financimin e këtyre shërbimeve.

OBJEKTIVAT

Cilat janë objektivat dhe efektet e synuara të propozimit?

Krijimi dhe funksionalizimi i një mekanizmi ligjor dhe administrativ për përcaktimin, aplikimin dhe mbledhjen e tarifave për shërbimet e trajtimit të aplikimeve për licenca dhe autorizime në fushën e artikujve piroteknikë, me qëllim mbulimin e kostove administrative dhe rritjen e transparencës e parashikueshmërisë për operatorët ekonomikë, brenda vitit 2027.

Objektivat specifike

- Reduktimi i barrës financiare që përballohet nga buxheti i AKSHE-së për shërbimet e licencimit dhe autorizimit, nëpërmjet rritjes së mbulimit të kostove administrative nga tarifat e paguara nga përfituesit, brenda vitit të parë të zbatimit të regjimit të ri tarifor.

OPSIONET E POLITIKAVE

Cilat janë opsionet kryesore të politikave, duke përfshirë mënyrat ndaj rregullimit? Duhet të bëni krahasimin e avantazheve/përfitimeve kryesore dhe të dizavantazheve/kostove të opsioneve të mundshme. Duhet të përcaktoni detajet në lidhje me opsionin e preferuar.

Opsioni 0 – Status quo

Ruajtja e kuadrit ligjor ekzistues, pa ndërhyrje në ligjin nr. 73/2021.

- Avantazhe: nuk kërkon procedurë legjislative dhe nuk gjeneron kosto hartimi.
- Disavantazhe: ruan boshllëkun ligjor dhe barrën prej rreth 183 270 lekë/vit mbi buxhetin e AKSHE-së; vijon pasiguria juridike.

Opsioni 1 – Ndryshimi i ligjit (opsioni i preferuar)

Dispozitë autorizuese në ligj për tarifat, të cilat miratohen me VKM mbi bazën e një metodologjie të llogaritjes së kostove.

- Avantazhe: krijon bazën ligjore, mundëson mbulimin e kostove, redukton barrën mbi buxhetin e AKSHE-së, rrit transparencën dhe standardizon tarifat.
- Disavantazhe: kërkon kohë dhe burime për metodologjinë dhe VKM-në; krijon kosto për operatorët (orientuese mesatarisht 14 900 lekë/aplikim); kërkon kapacitete për administrimin e arkëtimit.
- Nën-opsionet e modelit tarifor: 1A – tarifë fikse; 1B – tarifë e diferencuar sipas llojit të shërbimit; 1C – mbulim i pjesshëm i kostos; 1D – mbulim i plotë i kostos direkte. I rekomanduar: 1B + 1D, pasi llojet e shërbimeve kanë kompleksitet dhe kosto të ndryshme.

Opsioni 2 – Masa jorregullatore

Udhëzime ose akte të brendshme administrative dhe informim i operatorëve, pa ndryshuar ligjin.

- Avantazhe: zbatim i shpejtë dhe pa kosto të konsiderueshme.
- Disavantazhe: nuk krijon detyrim financiar për aplikuesit, nuk adreson shkakun e problemit dhe nuk mbulon kostot.

ANALIZA E NDIKIMEVE

Cilat janë ndikimet e opsionit të preferuar? Kjo duhet të përfshijë ndikimet me vlerë monetare të përcaktuar dhe ndikimet pa vlerë monetare të përcaktuar mbi buxhetin dhe bizneset.

Grupet e prekura dhe ndikimi: Nisma prek Ministrinë e Mbrojtjes, AKSHE-në, operatorët ekonomikë dhe institucionet bashkëpunuese, ndërsa qytetarët ndikohen vetëm në mënyrë indirekte. Ministria e Mbrojtjes do të ketë detyra kryesisht koordinuese për hartimin e VKM-së dhe monitorimin e sistemit tarifor, ndërsa AKSHE-ja do të përshtatë procedurat administrative, do të verifikojë dhe regjistrojë pagesat, do të mbajë regjistrin përkatës dhe do të raportojë kostot. Këto detyra përballohen me strukturat dhe stafin ekzistues, pa nevojën e krijimit të kapaciteteve të reja.

Ndikimi në administratën publike: Ndikimi pozitiv konsiston në krijimin e bazës ligjore për vendosjen e tarifave, rritjen e sigurisë juridike dhe mundësinë e mbulimit të kostove administrative të shërbimeve. Nga ana tjetër, kërkohet hartimi, zbatimi dhe monitorimi i sistemit tarifor, pa krijuar kosto të rëndësishme shtesë për buxhetin e shtetit.

Ndikimi te operatorët ekonomikë: Operatorët përfitojnë nga rritja e transparencës, parashikueshmërisë dhe qartësisë juridike të procedurave, por do të përballen me një kosto financiare shtesë për pagesën e tarifave të aplikimit. Tarifa orientuese mesatare vlerësohet në 14 900 lekë për aplikim, ndërsa niveli përfundimtar do të përcaktohet me VKM, duke u diferencuar sipas kategorisë së shërbimit dhe kostos përkatëse administrative.

Ndikimi te ndërmarrjet e vogla dhe të mesme: Nga katër subjektet aktive në fushën e artikujve piroteknikë, një është NVM. Kostoja shtesë orientuese për një deri në dy aplikime në vit vlerësohet

në 14 900–29 800 lekë. Meqenëse tarifa bazohet në koston e shqyrtimit të dosjes dhe jo në madhësinë e subjektit, rreziku i krijimit të një barre disproporcionale vlerësohet i ulët.

Ndikimet financiare dhe buxhetore: Bazuar në mesataren prej 12,3 licencash dhe autorizimesh në vit, kostoja administrative direkte vlerësohet në rreth 14 900 lekë për aplikim, ose 183 270 lekë në vit. Kjo përllogaritje përfshin 14 400 lekë kosto pune dhe 500 lekë printim për dosje. Nëse tarifat mbulojnë 100% të kostos direkte, të ardhurat e pritshme për buxhetin e shtetit vlerësohen në rreth 183 270 lekë në vit, pa krijuar shpenzime shtesë administrative. Efekti financiar neto i transferimit të kostos nga buxheti te operatorët vlerësohet zero.

Ndikimet indirekte: Nisma mund të kontribuojë në përmirësimin e administrimit të sistemit të licencimit dhe në çlirimin e burimeve të AKSHE-së për inspektim dhe monitorim, duke krijuar mundësi për forcimin e mbikëqyrjes dhe sigurisë publike. Megjithatë, ky ndikim është indirekt, i kufizuar dhe varet nga mënyra e përdorimit të burimeve të çliruara.

Kufizimet e analizës: Përllogaritjet financiare janë orientuese dhe bazohen në të dhënat administrative të AKSHE-së për periudhën 2021–2026, si dhe në supozime për kohën e punës, koston për orë dhe shpenzimet e printimit. Tarifat konkrete nuk janë përcaktuar ende dhe do të miratohen me VKM, ndaj ndikimi financiar përfundimtar te operatorët nuk mund të përcaktohet në këtë fazë.

ARSYETIMI I OPSIONIT TË PREFERUAR

Shpjegoni arsyet për zgjedhjen e opsionit të preferuar. Ju lutemi jepni nëse është e mundur koston dhe përfitimin me vlerë të përcaktuar monetare.

Opsioni 1 përfaqëson alternativën më efektive dhe proporcionale për zgjidhjen e problemit të identifikuar.
Ndryshe nga Opsioni 0, ai eliminon boshllëkun ligjor dhe mundëson krijimin e bazës ligjore për tarifat. Ndryshe nga Opsioni 2, ai ofron një zgjidhje juridikisht të qëndrueshme dhe të zbatueshme. Analiza me shumë kritere (Pjesa 2) jep këto rezultate: Opsioni 1 – 89 pikë, Opsioni 2 – 30 pikë, Opsioni 0 – 23 pikë (nga 100 pikë maksimum).
Opsioni 1 siguron ekuilibrin më të mirë ndërmjet sigurisë juridike, efektivitetit administrativ dhe proporcionalitetit të ndërhyrjes. Ai përbën instrumentin minimal të nevojshëm për adresimin e problemit, pa krijuar struktura të reja administrative dhe pa imponuar kërkesa të reja procedurale për operatorët ekonomikë.

KOSTOJA E PËRLLOGARITUR MBI BUXHETIN E SHTETIT

Projektligji nuk kërkon ngritjen e strukturave të reja dhe nuk sjell kosto shtesë për buxhetin e shtetit. Të ardhurat e mundshme nga tarifat derdhen në Buxhetin e Shtetit.

Periudha	Kosto
Viti 1	0 lekë
Viti 2	0 lekë

Viti 3	0 lekë

KONSULTIMI

Jepni një përmbledhje të çdo konsultimi të kryer (me kë dhe si jeni konsultuar?), çfarë pikëpamjesh janë shprehur, si janë trajtuar ato, domethënë çfarë ndryshimesh janë pranuar dhe çfarë janë refuzuar dhe arsyet pse?)

Projektligji është hartuar nga Ministria e Mbrojtjes dhe Autoriteti i Kontrollit Shtetëror të Eksporteve (AKSHE).
Projektligji " Për një ndryshim në ligjin nr. 73/2021, "Për hedhjen në treg dhe mbikëqyrjen e artikujve piroteknikë", u konsultua nëpërmjet metodave të përshkruara më poshtë:

1. Projektligji është publikuar për konsultim publik nëpërmjet publikimit në RENJK, nga data 06.10.2026 deri më datë 03.11.2026, duke respektuar afatin kohor 20 ditë pune, sikurse kërkon ligji nr. 146/2014, "Për njoftimin dhe konsultimin publik", në linkun https://www.konsultimipublik.gov.al/Konsultime/Detaje/1060. Në përfundim të procesit të konsultimit publik nuk ka pasur komente apo sugjerime nga grupet e interesit, pavarësisht numrit të shikimeve të projektaktit i cili ka qenë 210.

2. Me qëllim lehtësimin e dhënies së komenteve/sugjerimeve nga çdo i interesuar, në faqen zyrtare të Ministrisë së Mbrojtjes, në rubrikën e dedikuar për konsultimin publik, krahas draftit të projektligjit është vënë në dispozicion edhe adresa elektronike konsultim.publik@mod.gov.al, për të cilën në përfundim të procesit të konsultimit publik nuk ka pasur komente apo sugjerime nga grupet e interesit.

3. Çdo palë e interesuar mund të dërgonte në formë shkresore, në adresë të Ministrisë së Mbrojtjes të gjitha komentet/sugjerimet mbi përmbajtjen e projektligjit, për të cilën në përfundim të procesit të konsultimit publik nuk ka pasur komente apo sugjerime.

4. Autoriteti i Kontrollit Shtetëror të Eksporteve zhvilloi një sërë takimesh me strukturat përkatëse të institucioneve kryesore të përfshira në proces, për të diskutuar mbi përmirësimin dhe qartësimin e parashikimeve ligjore lidhur me importin, eksportin dhe transitin e armëve të zjarrit, komponentëve të tyre kryesorë dhe municioneve.
Komentet/sugjerimet e propozuara janë përfshirë në hartimin e projektligjit.

5. Projektligji nuk ka marrë komente gjatë tryezave konsultative dhe në rubrikën përkatëse në RENJKP, por ka marrë komente vetëm nëpërmjet sistemit e-Aktet, të cilat janë duke u marrë në konsideratë, trajtuar, refuzuar apo reflektuar rast pas rasti, gjatë procesit të hartimit të dokumentit.

ZBATIMI DHE MONITORIMI

Si do të organizohen zbatimi dhe monitorimi?

AKSHE përgatit metodologjinë e llogaritjes së kostove dhe projekt-VKM-në; Ministria e Mbrojtjes e propozon në Këshillin e Ministrave pas marrjes së mendimit të ministrive të linjës. VKM-ja miratohet brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e ligjit; deri atëherë aplikimet trajtohen pa tarifë.

Monitorimi: AKSHE është institucioni përgjegjës për mbledhjen e të dhënave dhe monitorimin e treguesve; Ministria e Mbrojtjes është institucioni raportues për arritjen e objektivave. AKSHE i raporton çdo vit Ministrisë së Mbrojtjes mbi tarifat e arkëtuara, kostot e shërbimeve dhe shkallën e mbulimit të tyre; pas 3 vitesh zbatimi kryhet vlerësimi ex-post dhe, sipas nevojës, rishikimi i tarifave.

PJESA 2: BAZA KRYESORE E ANALIZËS DHE E PROVAVE

Historik

- *Jepni kontekstin e politikës*

Para hyrjes në fuqi të ligjit nr. 73/2021 "Për hedhjen në treg dhe mbikëqyrjen e artikujve piroteknikë", tarifat për licencat dhe autorizimet për artikujt piroteknikë zbatoheshin në bazë të Urdhërit të Ministrit të Mbrojtjes nr.155, datë 21.03.2005 "Për tarifat financiare për dhënien e lejeve të importimit, eksportimit dhe prodhimit të lëndëve piroteknike, fishekziarre për përdorim civil.", i ndryshuar.
Me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 73/2021 u krijua një sistem i ri rregullator për licencimin, autorizimin dhe mbikëqyrjen e artikujve piroteknikë. Megjithatë, ligji nuk parashikoi një bazë të posaçme ligjore për përcaktimin dhe mbledhjen e tarifave për trajtimin e kërkesave për licenca dhe autorizime.
Si rezultat, që nga hyrja në fuqi e ligjit nuk janë aplikuar tarifa administrative për këto procedura, pavarësisht vazhdimit të aktivitetit administrativ të AKSHE-së.
Gjatë zbatimit të ligjit, AKSHE ka vijuar të kryejë verifikimin e dokumentacionit, shqyrtimin e aplikimeve, koordinimin me institucionet përgjegjëse, monitorimin dhe inspektimin e subjekteve, duke përdorur burimet ekzistuese njerëzore dhe financiare.
Autoriteti i Kontrollit Shtetëror të Eksporteve (AKSHE) është autoriteti kompetent për shqyrtimin e aplikimeve, lëshimin e licencave dhe autorizimeve, si dhe monitorimin dhe kontrollin e subjekteve.
Gjatë zbatimit të ligjit është konstatuar se ai nuk përmban dispozitë të posaçme që autorizon përcaktimin e tarifave për trajtimin e aplikimeve për licenca dhe autorizime. Si pasojë, pas hyrjes në fuqi të ligjit nr. 73/2021, nuk ekziston bazë e qartë ligjore për vendosjen dhe arkëtimin e këtyre tarifave.
Megjithatë, procedurat administrative vijojnë të kryhen nga AKSHE, duke përfshirë verifikimin e dokumentacionit, koordinimin institucional, kontrollin administrativ dhe mbikëqyrjen e subjekteve. Këto veprimtari realizohen me burimet ekzistuese financiare dhe njerëzore të institucionit.
Funksionimi aktual i regjimit të licencimit/autorizimit. Kërkesat për licencë ose autorizim paraqiten elektronikisht nëpërmjet portalit e-Albania. AKSHE verifikon plotësinë dhe vërtetësinë e dokumentacionit, koordinohet sipas rastit me institucionet e tjera përgjegjëse, shqyrton kërkesën në thelb dhe vendos për dhënien ose refuzimin e licencës/autorizimit; pas lëshimit ushtron monitorimin dhe kontrollin e subjektit. Në shqyrtimin e një dosjeje angazhohen 18 punonjës. Aktualisht shërbimi ofrohet pa pagesë.
Akti i mëparshëm që përcaktonte tarifat. Urdhërit të Ministrit të Mbrojtjes nr.155, datë 21.03.2005 "Për tarifat financiare për dhënien e lejeve të importimit, eksportimit dhe prodhimit të lëndëve piroteknike, fishekziarre për përdorim civil.", i ndryshuar parashikonte tarifat e mëposhtme:
Licence import/eksporti - 10 000 lekë
Licence prodhimi - 1000 000 lekë
Rinovimi i licencës së prodhimit - 500 000 lekë.

Pas hyrjes në fuqi të ligjit nr. 73/2021 ky akt nuk gjen më zbatim, pasi ligji i ri nuk përmban bazë ligjore për tarifat.
Praktika faktike që nga viti 2021. Që nga hyrja në fuqi e ligjit nr. 73/2021 nuk është aplikuar dhe nuk është arkëtuar asnjë tarifë për licencat dhe autorizimet. Nuk ka pasur raste arkëtimi të pjesshëm apo pengesa në arkëtim, pasi në mungesë të bazës ligjore arkëtimi nuk është kryer fare. Gjatë kësaj periudhe janë lëshuar 74 licenca/autorizime, të trajtuara tërësisht me burimet e AKSHE-së.
Nisma lidhet me dokumentet strategjike të mëposhtme:

Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Evropian 2022–2030 (SKZHIE III) – objektivat për forcimin e shtetit të së drejtës dhe sigurisë juridike, përmirësimin e qeverisjes dhe kapaciteteve administrative dhe ofrimin e shërbimeve publike më efektive dhe transparente. Nisma kontribuon në qartësimin e kuadrit ligjor për tarifat administrative dhe në krijimin e një mekanizmi më të qartë, transparent dhe të parashikueshëm për tarifimin e trajtimit të aplikimeve për licenca dhe autorizime.

Strategjia Ndërsektoriale për Reformën në Administratën Publike 2024–2030 – përmirësimi i efikasitetit dhe cilësisë së shërbimeve administrative dhe administrimi më efektiv i burimeve publike. Krijimi i bazës ligjore për tarifat synon një kuadër të qartë për mbulimin e kostove administrative të këtij shërbimi, duke rritur transparencën dhe parashikueshmërinë për administratën dhe operatorët ekonomikë.
Strategjia Kombëtare për Kontrollin e Armëve të Vogla, të Lehta, Municioneve dhe Eksplozivëve – forcimi i kontrollit shtetëror mbi qarkullimin e materialeve shpërthyese, të cilit i shërben një sistem licencimi i financuar në mënyrë të qëndrueshme.
Strategjia Kombëtare për Menaxhimin e Financave Publike 2023–2030 – administrimi i të ardhurave publike, mbulimi i kostove të shërbimeve dhe përdorimi eficient i burimeve buxhetore. Nisma krijon një mekanizëm që shërbimet e licencimit të financohen nga përfituesit e tyre, duke ulur barrën mbi buxhetin dhe duke e lidhur tarifën me koston reale të shërbimit.

Problemi në shqyrtim

- *Përshkruani natyrën e problemit.*
- *Identifikoni shkaqet e problemit.*
- *Përshkruani shtrirjen e problemit.*
- *Identifikoni grupet e prekura nga ky problem - qeveria / biznesi / shoqëria civile / qytetarët.*
- *Vlerësoni nëse problemi mund të trajtohet ose jo përmes një ndryshimi të politikave.*

Natyra e problemit

Problemi qëndron në mospërputhjen ndërmjet kostove reale që AKSHE përballon për ofrimin e shërbimeve të licencimit dhe autorizimit dhe mungesës së një mekanizmi ligjor për financimin e tyre përmes tarifave. Shërbimi ka një kosto të matshme (verifikim, koordinim, shqyrtim, vendimmarrje, arkivim dhe monitorim), por ligji nr. 73/2021 nuk parashikon instrumentin që kjo kosto të mbulohet nga përfituesit e shërbimit. Problemi nuk është thjesht humbje e të ardhurave, por mungesë e lidhjes ndërmjet kostos së shërbimit dhe burimit të financimit të tij: kostot përballohen tërësisht nga buxheti i institucionit dhe aplikuesit trajtohen ndryshe në raport me periudhën kur shërbimi tarifohej.
Efektet konkrete të mungesës së një baze ligjore për vendosjen e tarifave janë:

- Që nga viti 2021 AKSHE ka lëshuar 74 akte (licenca dhe autorizime) pa arkëtuar të ardhura nga tarifimi i këtyre shërbimeve;

- Bazuar në një kosto orientuese mesatare direkte prej 14 900 lekësh për dosje, kostoja e pambuluar nga përfituesit e shërbimit vlerësohet në rreth 183 270 lekë në vit dhe rreth 1 102 600 lekë për periudhën 2021–2026;

- Kostot e kryerjes së këtyre shërbimeve përballohen tërësisht nga buxheti i AKSHE-së, duke kufizuar mundësinë e përdorimit të burimeve financiare dhe njerëzore për përmbushjen e funksioneve të tjera institucionale, veçanërisht ato që lidhen me mbikëqyrjen dhe kontrollin;

- Për çdo aplikim, AKSHE kryen një sërë veprimtarish administrative dhe teknike, përfshirë verifikimin e dokumentacionit, koordinimin ndërinstitucional, shqyrtimin e aplikimit, marrjen e vendimit, arkivimin dhe monitorimin pas lëshimit të licencës/autorizimit, pa pasur mundësi të mbulojë kostot përkatëse nëpërmjet tarifimit të aplikuesit;

- Mungesa e tarifimit krijon një ndryshim në trajtimin financiar të të njëjtit shërbim krahasuar me periudhën përpara vitit 2021, kur për ofrimin e tij aplikuesit paguanin tarifë administrative.

Shkaqet

Shkaku rrënjësor: Ligji nr. 73/2021 nuk parashikon një dispozitë autorizuese që të mundësojë përcaktimin dhe mbledhjen e tarifave për shërbimet e licencimit/autorizimit të ofruara nga AKSHE. Për rrjedhojë, institucioni nuk ka bazën e nevojshme ligjore për të vendosur dhe arkëtuar këto tarifa.

Shkaqet dytësore:

- Mosreflektimi në ligjin nr. 73/2021 i regjimit tarifor të mëparshëm: Urdhri i Ministrit të Mbrojtjes nr. 155, datë 21.03.2005, "Për tarifat financiare për dhënien e lejeve të importimit, eksportimit dhe prodhimit të lëndëve piroteknike, fishekzjarre për përdorim civil", i ndryshuar parashikonte tarifa (10 000 lekë për licencën e importit/eksportit, 1 000 000 lekë për licencën e prodhimit dhe 500 000 lekë për rinovimin e saj). Ligji i ri nuk përfshiu një dispozitë që ta ruante ose ta zëvendësonte këtë regjim, prandaj akti mbeti pa bazë ligjore.
- Mungesa e një metodologjie të miratuar për llogaritjen e kostos së shërbimit – shkak plotësues: edhe me bazë ligjore, pa metodologji tarifat nuk mund të përcaktohen në mënyrë të argumentuar. Metodologjia nuk e zëvendëson bazën ligjore, por është kusht për zbatimin e saj.

Pse nuk u parashikuan tarifat në vitin 2021. Gjatë hartimit të ligjit nr. 73/2021 vëmendja u përqendrua te kërkesat për hedhjen në treg, kategorizimin, etiketimin, ruajtjen dhe mbikëqyrjen e artikujve piroteknikë; çështja e tarifave dhe e fatit të aktit të mëparshëm nuk u trajtua në ligj.
Ndryshime të tjera pas vitit 2021. Nuk janë konstatuar ndryshime të tjera institucionale apo procedurale që të kenë ndikuar në këtë problem. Problemi është kryesisht mungesë e autorizimit ligjor për tarifën; procedurat e administrimit të licencimit funksionojnë dhe nuk ndryshohen nga projektligji.

Pasojat

- Pamundësia e AKSHE-së për të mbuluar kostot administrative të shqyrtimit dhe trajtimit të aplikimeve nëpërmjet tarifimit të përfituesve të shërbimit.
- Transferimi i plotë i kostove të ofrimit të shërbimit te buxheti i institucionit, duke kufizuar burimet financiare të disponueshme për ushtrimin e funksioneve të tjera institucionale.

- Pasiguri juridike për administratën dhe operatorët ekonomikë lidhur me ekzistencën, bazën ligjore dhe mënyrën e aplikimit të tarifave.
- Mungesa e një mekanizmi të standardizuar dhe transparent për përcaktimin e tarifave, në përputhje me kostot reale të shërbimeve të ofruara.
- Pamundësia e miratimit të një VKM-je për tarifat, si pasojë e drejtpërdrejtë e mungesës së dispozitës autorizuese në ligj.

Evidencat

Mesatarja vjetore e procedurave të administruara rezulton rreth **12.3 licenca/autorizime në vit** (74 procedura gjatë 6 viteve).

Viti	**Licenca/autorizime të lëshuara**
2021	18
2022	9
2023	10
2024	11
2025	16
2026	10
Totali	**74**

Sqarim për të dhënat. Numri 74 përfaqëson akte të lëshuara (licenca dhe autorizime), jo numrin e aplikimeve. Numri i aplikimeve të trajtuara mund të jetë më i madh, pasi përfshin edhe aplikimet e refuzuara **Lidhja me numrin e subjekteve.** Aktualisht janë 4 subjekte të licencuara/autorizuara. Një subjekt mund të përfitojë më shumë se një akt: licenca jepet për ushtrimin e veprimtarisë (prodhim ose import/eksport), ndërsa autorizimi jepet për çdo operacion importi, eksporti ose transiti. Për rrjedhojë, 74 aktet e periudhës 2021–2026 u përkasin këtyre 4 subjekteve, me mesatarisht rreth 18 akte për subjekt.

Numri i subjekteve aktualisht të licencuara/autorizuara: 4.
Shpërndarja e akteve sipas llojit të shërbimit (2021–2026):

Grupet e prekura

- Ministria e Mbrojtjes;
- AKSHE;
- operatorët ekonomikë;
- institucionet bashkëpunuese;
- qytetarët në mënyrë indirekte.

Vlerësimi nëse problemi mund të trajtohet përmes ndryshimit të politikave

Problemi lidhet me mungesën e bazës ligjore për tarifat dhe, në parim, mund të trajtohet përmes ndërhyrjes së politikave. Për përzgjedhjen e instrumentit të duhur janë shqyrtuar opsione rregullatore dhe jorregullatore – mosndërhyrja, masat jorregullatore dhe ndryshimi i ligjit me modele të ndryshme tarifore (shih "Përshkrimi i opsioneve të shqyrtuara"). Zgjedhja bëhet mbi bazën e vlerësimit krahasues të këtyre opsioneve.

Arsyeja e ndërhyrjes

- *Shpjegoni pse qeveria planifikon të ndërhyjë dhe pse është e nevojshme.*
- *Shpjegoni se çfarë shpreson të trajtojë qeveria nëpërmjet kësaj ndërhyrjeje.*

- *Identifikoni shkallën e ndërhyrjes së qeverisë që nevojitet për të trajtuar problemin.*
- *Shpjegoni se si i mbështet kjo ndërhyrje objektivat e nivelit të lartë të qeverisë.*
- *Rendisni punën ekzistuese që është realizuar tashmë.*

Praktika administrative e viteve 2021–2026 tregon se AKSHE ka administruar një numër të konsiderueshëm procedurash licencimi dhe autorizimi pa mundësinë e arkëtimit të tarifave administrative, megjithëse këto procedura kërkojnë angazhim institucional, verifikim dokumentacioni, koordinim dhe monitorim të vazhdueshëm.
Prandaj ndërhyrja ligjore konsiderohet e nevojshme për të krijuar bazën ligjore që mundëson miratimin e tarifave me VKM.

a) Pse qeveria e sheh të nevojshme të ndërhyjë

- **Interesi publik:** licencimi dhe autorizimi i veprimtarive me artikuj piroteknikë është funksion i domosdoshëm i shtetit për mbrojtjen e sigurisë publike; vazhdimësia dhe cilësia e tij duhet të mbështeten në burime të qëndrueshme.
- **Nevoja për ndërhyrje shtetërore:** tarifat për shërbime publike mund të vendosen vetëm me bazë ligjore; problemi nuk mund të zgjidhet nga tregu, nga operatorët apo nga AKSHE me akt të brendshëm.
- **Lidhja kosto–tarifë dhe proporcionaliteti:** tarifa synon të mbulojë koston e verifikuar të trajtimit të aplikimit (orientuese 14 900 lekë/dosje) dhe nuk duhet ta tejkalojë atë; ajo është pagesë për shërbim dhe jo instrument fiskal. Ndërhyrja kufizohet në krijimin e bazës ligjore, ndërsa niveli konkret përcaktohet me VKM mbi bazë kostoje.
- **Në interes të dy palëve:** administrata mbulon koston e shërbimit dhe lehtëson buxhetin, ndërsa operatorët përfitojnë siguri juridike dhe tarifa të publikuara e të parashikueshme.

b) Çfarë synon të arrijë qeveria përmes kësaj ndërhyrjeje

- Krijimin e një baze të qartë ligjore për përcaktimin dhe mbledhjen e tarifave administrative, duke mundësuar miratimin dhe zbatimin e një regjimi tarifor për shërbimet e licencimit dhe autorizimit të ofruara nga AKSHE.
- Mbulimin e kostove administrative të ofrimit të shërbimeve, nëpërmjet vendosjes së tarifave që reflektojnë kostot përkatëse dhe reduktimin e barrës financiare që aktualisht përballohet nga buxheti i institucionit.
- Rritjen e transparencës dhe sigurisë juridike për operatorët ekonomikë, nëpërmjet përcaktimit të qartë, publikimit dhe zbatimit të tarifave sipas një metodologjie të miratuar për llogaritjen e kostove.
- Përmirësimin e qëndrueshmërisë financiare dhe administrative të sistemit të licencimit, duke krijuar një mekanizëm të parashikueshëm për mbulimin e kostove të shërbimeve dhe duke mundësuar administrimin më eficient të burimeve institucionale.

c) Si mbështet ndërhyrja objektivat e nivelit të lartë të qeverisë

Nisma kontribuon drejtpërdrejt në arritjen e objektivave të SKZHIE III në drejtim të forcimit të shtetit të së drejtës, sigurisë juridike dhe ofrimit të shërbimeve publike transparente; të Strategjisë Ndërsektoriale për Reformën në Administratën Publike 2024–2030 (efikasiteti i shërbimeve dhe administrimi efektiv i burimeve publike); dhe të Strategjisë Kombëtare për Menaxhimin e Financave Publike 2023–2030 (administrimi i të ardhurave publike dhe përdorimi eficient i burimeve buxhetore).

d) Puna ekzistuese e realizuar

1. Para vitit 2021 shërbimi tarifohej sipas Urdhrit të Ministrit të Mbrojtjes nr. 155, datë 21.03.2005, i ndryshuar, me këto tarifa: licencë importi/eksporti – 10 000 lekë; licencë prodhimi – 1 000 000 lekë; rinovim i licencës së prodhimit – 500 000 lekë. Tarifat arkëtoheshin nëpërmjet bankave.
2. Pas hyrjes në fuqi të ligjit nr. 73/2021, AKSHE, si strukturë përgjegjëse, ka vijuar ofrimin e shërbimit pa tarifë.
3. AKSHE ka identifikuar boshllëkun ligjor dhe ka informuar Ministrinë e Mbrojtjes; Ministria e Mbrojtjes, si ministri përgjegjëse për politikën, ka nisur procesin e ndryshimit të ligjit.
4. AKSHE ka mbledhur dhe analizuar të dhënat administrative për periudhën 2021–2026, duke evidentuar numrin e licencave/autorizimeve të trajtuara dhe llojet e shërbimeve të ofruara.
5. Është kryer një vlerësim paraprak i kostove administrative të trajtimit të aplikimeve, me një kosto orientuese mesatare prej 14 900 lekësh për dosje, e përbërë nga kostoja e punës (14 400 lekë) dhe printimi (500 lekë). Metodologjia dhe elementet përbërëse të kostos jepen në seksionin "Përllogaritja e kostos për një licencë/autorizim"; kostot sipas kategorive të shërbimit do të përcaktohen në metodologjinë që shoqëron VKM-në.

Objektivi i politikës

- *Vendosni objektiva që korrespondojnë me problemin dhe shkaqet e tij.*
- *Sigurohuni që objektivat janë specifikë, të matshëm, të arritshëm, realë dhe në kohë.*

Objektivi i përgjithshëm

Krijimi dhe funksionalizimi i një mekanizmi ligjor dhe administrativ për përcaktimin, aplikimin dhe mbledhjen e tarifave për shërbimet e trajtimit të aplikimeve për licenca dhe autorizime në fushën e artikujve piroteknikë, me qëllim mbulimin e kostove administrative të ofrimit të këtyre shërbimeve dhe rritjen e transparencës e parashikueshmërisë për operatorët ekonomikë, brenda vitit 2027.

Objektivat specifike

- Reduktimi i barrës financiare që përballohet nga buxheti i AKSHE-së për ofrimin e shërbimeve të licencimit dhe autorizimit, nëpërmjet rritjes së mbulimit të kostove administrative nga tarifat e paguara nga përfituesit e shërbimeve, brenda vitit të parë të zbatimit të regjimit të ri tarifor.
- Sigurimi i një trajtimi të barabartë dhe të parashikueshëm për operatorët ekonomikë, përmes zbatimit të një regjimi tarifor të qartë, të standardizuar dhe proporcional me natyrën dhe kostot e shërbimeve të ofruara.
- Përmirësimi i eficiencës në përdorimin e burimeve institucionale të AKSHE-së, duke mundësuar që burimet financiare të institucionit të përdoren në mënyrë më efektive për përmbushjen e funksioneve të tij, përfshirë mbikëqyrjen dhe kontrollin.

Përshkrimi i opsioneve të shqyrtuara

- *Përshkruani opsionin e status quo-së.*
- *Identifikoni dhe përshkruani të gjitha opsionet e politikave që keni marrë parasysh.*
- *Shpjegoni se si janë zgjedhur opsionet e renditura.*

Opsioni 0 – Status Quo

Ky opsion parashikon ruajtjen e kuadrit ligjor ekzistues, pa ndërhyrje në ligjin nr. 73/2021, duke mos krijuar një bazë të posaçme ligjore për përcaktimin dhe arkëtimin e tarifave për shërbimet e licencimit dhe autorizimit të ofruara nga AKSHE në fushën e artikujve piroteknikë.
Me këtë opsion, AKSHE do të vijojë të shqyrtojë dhe trajtojë aplikimet për licenca dhe autorizime, pa u ngarkuar aplikuesve tarifa për mbulimin e kostove administrative. Kostot e përpunimit të aplikimeve, përfshirë verifikimin e dokumentacionit, koordinimin ndërinstitucional, shqyrtimin dhe administrimin e dosjeve, do të vijojnë të përballohen nga buxheti i institucionit. Ruajtja e situatës aktuale do të nënkuptonte vijimin e mungesës së një mekanizmi të qartë dhe të standardizuar për mbulimin e kostove nga përfituesit, ndërsa nuk do të krijoheshin kushtet për një regjim tarifor transparent dhe të parashikueshëm.

Avantazhet

- Nuk kërkon ndryshime në kuadrin ligjor ekzistues dhe shmang procesin e hartimit, konsultimit dhe miratimit të ndryshimeve ligjore.
- Nuk gjeneron kosto shtesë afatshkurtra për institucionet, në lidhje me procesin e hartimit dhe miratimit të një akti të ri ligjor.
- Shmang angazhimin e burimeve administrative dhe njerëzore për zhvillimin e procesit të ndryshimeve ligjore dhe akteve nënligjore përkatëse.

Disavantazhet

- Mban në fuqi boshllëkun ligjor, duke mos krijuar mundësinë e vendosjes dhe arkëtimit të tarifave për shërbimet e licencimit dhe autorizimit të ofruara nga AKSHE.
- Nuk mundëson mbulimin e kostove administrative nga përfituesit e shërbimeve, duke bërë që këto kosto (rreth 183 270 lekë/vit) të vijojnë të përballohen nga buxheti i AKSHE-së.
- Vijon të krijojë pasiguri juridike dhe mungesë parashikueshmërie lidhur me regjimin e tarifimit të këtyre shërbimeve.
- Në afatgjatë, ruan barrën financiare mbi buxhetin e AKSHE-së dhe kufizon mundësinë e përdorimit të burimeve të institucionit për funksionet e tjera të tij.

Opsioni 1 – Ndryshimi i ligjit (opsioni i preferuar)

Ky opsion parashikon ndërhyrjen në ligjin nr. 73/2021, me qëllim plotësimin e tij me një dispozitë që autorizon përcaktimin dhe arkëtimin e tarifave për shërbimet e licencimit dhe autorizimit të ofruara nga AKSHE në fushën e artikujve piroteknikë.
Nëpërmjet këtij ndryshimi synohet krijimi i bazës së nevojshme ligjore për miratimin, me vendim të Këshillit të Ministrave, të tarifave përkatëse, duke përcaktuar kategoritë e shërbimeve që do t'i nënshtrohen tarifimit dhe mënyrën e zbatimit të tyre. Tarifat do të duhet të mbështeten në një metodologji të argumentuar të llogaritjes së kostove administrative të shërbimeve, duke siguruar proporcionalitetin ndërmjet tarifës dhe kostos së shërbimit të ofruar.

Avantazhet

- Krijon bazën e nevojshme ligjore për përcaktimin dhe arkëtimin e tarifave për shërbimet e ofruara nga AKSHE.
- Mundëson mbulimin e plotë ose të pjesshëm të kostove administrative nga përfituesit e shërbimeve, në varësi të nivelit të tarifave që do të miratohen.

- Redukton barrën financiare që aktualisht përballohet nga buxheti i AKSHE-së.
- Rrit transparencën dhe parashikueshmërinë për operatorët ekonomikë, përmes përcaktimit të qartë të shërbimeve që tarifohen dhe vlerës së tarifave.
- Mundëson standardizimin e tarifave mbi bazën e kostove reale të ofrimit të shërbimeve.

Disavantazhet

- Kërkon kohë dhe burime administrative për hartimin, konsultimin dhe miratimin e ndryshimeve ligjore, si dhe të akteve nënligjore në zbatim të tyre.
- Sjell kosto administrative për hartimin e metodologjisë së llogaritjes së tarifave dhe përgatitjen e vendimit të Këshillit të Ministrave.

- Mund të rrisë kostot e përmbushjes së detyrimeve për operatorët ekonomikë, të cilët do të duhet të paguajnë tarifa për shërbimet e përfituara.
- Kërkon kapacitete administrative për administrimin e arkëtimit të tarifave dhe verifikimin e pagesave.

Projektligji nuk krijon avantazhe apo disavantazhe selektive për operatorë të caktuar ekonomikë. Tarifat do të aplikohen në mënyrë të barabartë për të gjithë subjektet që kryejnë veprimtari të rregulluara nga ligji.

Nën-opsionet e modelit tarifor (për t'u përcaktuar me VKM)

Brenda Opsionit 1 janë shqyrtuar alternativat e mëposhtme për modelin e tarifës:

- **1A – Tarifë fikse, e njëjtë për të gjitha licencat/autorizimet:** e thjeshtë për t'u administruar dhe e parashikueshme; por nuk pasqyron ndryshimet në kompleksitet dhe kosto ndërmjet llojeve të procedurave dhe mund të jetë disproporcionale për procedurat më të thjeshta.
- **1B – Tarifë e diferencuar sipas llojit të licencës/autorizimit:** pasqyron më mirë koston e secilës procedurë dhe është më proporcionale; kërkon llogaritje kostoje për çdo lloj procedure.
- **1C – Tarifë që mbulon pjesërisht koston:** ul barrën mbi operatorët, por vazhdon subvencionimin e shërbimit nga buxheti pa një arsye politike të justifikuar.
- **1D – Tarifë që mbulon plotësisht koston direkte të shërbimit:** siguron mbulimin e kostos dhe trajtim të barabartë të përfituesve, pa e tejkaluar koston e shërbimit.
- **1E – Tarifë mbi koston e shërbimit:** e papranueshme, pasi do ta shndërronte tarifën në instrument fiskal dhe do të cenonte parimin e proporcionalitetit.

Modeli i rekomanduar për t'u reflektuar në VKM është kombinimi **1B + 1D**: tarifë e diferencuar sipas llojit të licencës/autorizimit, e llogaritur mbi koston e verifikuar të shërbimit dhe që nuk e tejkalon atë.

Opsioni 2 – Masa jorregullatore

Ky opsion parashikon adresimin e problematikës përmes masave administrative, pa ndërhyrë në ligjin nr. 73/2021. Këto masa mund të përfshijnë nxjerrjen e udhëzimeve ose akteve të brendshme administrative nga institucionet përgjegjëse, me qëllim standardizimin e procedurave të trajtimit të aplikimeve për licenca dhe autorizime, përmirësimin e koordinimit ndërinstitucional dhe informimin e operatorëve ekonomikë mbi dokumentacionin dhe procedurat përkatëse.
Megjithatë, këto masa nuk mund të krijojnë vetë një detyrim financiar për aplikuesit dhe as të mundësojnë vendosjen dhe arkëtimin e tarifave, në mungesë të një autorizimi të shprehur në ligj. Për rrjedhojë, edhe nëse përmirësojnë administrimin e shërbimeve dhe qartësinë procedurale, ato nuk adresojnë shkakun kryesor të problemit, që lidhet me mungesën e bazës ligjore për tarifimin e shërbimeve të AKSHE-së.

Avantazhet: nuk kërkon ndryshime legjislative dhe shmang procedurat për hartimin dhe miratimin e tyre. Disa masa administrative, veçanërisht ato që lidhen me informimin dhe orientimin e operatorëve ekonomikë, mund të ndërmerren në një periudhë relativisht të shkurtër dhe mund të përmirësojnë transparencën dhe zbatimin e procedurave, pa kërkuar angazhim të konsiderueshëm të burimeve financiare. Janë shqyrtuar masat jorregullatore të mëposhtme:

- **Vazhdimi i praktikës aktuale pa tarifë** – nuk e zgjidh problemin; kostoja vazhdon të përballohet tërësisht nga buxheti.
- **Rizbatimi i aktit të mëparshëm për tarifat** – nuk është i mundur, pasi akti nuk ka bazë ligjore në ligjin nr. 73/2021.
- **Urdhër/udhëzim i ministrit ose akt i brendshëm i AKSHE-së për tarifat** – nuk është i ligjshëm, pasi tarifat publike vendosen vetëm mbi bazë ligjore.
- **Informim dhe udhëzues për operatorët** – rrisin transparencën e procedurës, por nuk krijojnë bazë për arkëtimin e tarifave.

Disavantazhet

- Nuk adreson shkakun kryesor të problemit, që lidhet me mungesën e bazës ligjore për përcaktimin dhe arkëtimin e tarifave.
- Nuk mundëson mbulimin e kostove administrative nga përfituesit e shërbimeve, duke ruajtur barrën financiare mbi buxhetin e AKSHE-së.
- Nuk siguron një zgjidhje të qëndrueshme juridike për vendosjen e regjimit tarifor.
- Masat e informimit dhe standardizimit procedural mund të përmirësojnë administrimin e shërbimeve, por kanë efekt të kufizuar në adresimin e problematikës financiare dhe ligjore.

Vlerësimi i opsioneve/analizimi i ndikimeve

- *Identifikoni se kush preket.*
- *Identifikoni llojet e ndikimeve për secilin grup të prekur; bëni dallimin midis ndikimeve të drejtpërdrejta dhe jo të drejtpërdrejta.*
- *Për ndikimet e drejtpërdrejta:*
    - *Përshkruani nga ana cilësore ndikimet e drejtpërdrejta mbi grupet e prekura.*
    - *Analizoni nga ana sasiore ndikimet më të rëndësishme të drejtpërdrejta.*
    - *Përcaktoni vlerën monetare të ndikimeve më të rëndësishme të drejtpërdrejta aty ku është e mundur (shih aneksin 1/a për tabelën që mund të përdorni).*
    - *Analizoni ndikimin mbi ndërmarrjet e vogla dhe të mesme.*
- *Për ndikimet jo të drejtpërdrejta:*
    - *Përshkruani nga ana cilësore ndikimet jo të drejtpërdrejta mbi grupet e prekura.*
    - *Analizoni ndikimin mbi konkurrencën.*
- *Diskutoni kufizimin e analizës:*
    - *Jepni supozimet në të cilat janë bazuar parashikimet dhe risqet, të cilave ato u nënshtrohen.*
    - *Tregoni sa të forta, të pavarura dhe të rëndësishme janë provat që mbështesin supozimet.*
    - *Tregoni se çfarë mund të pengojë realizimin e përfitimeve, të rrisë kostot ose të sjellë pasoja të papritura.*
- *Përmblidhni vlerësimin e opsioneve:*
    - *Paraqisni një pasqyrë përmbledhëse të të gjitha ndikimeve të opsioneve të analizuara.*
    - *Shpjegoni se si ndikimet e të gjitha opsioneve të analizuara krahasohen me njëra-tjetrën.*

Paraqisni përllogaritjet më të mira të përgjithshme neto të ndikimit me vlerë monetare të përcaktuar për çdo opsion (shih aneksin 1/b për tabelën që mund të përdorni).

Grupet e prekura

- Ministria e Mbrojtjes;
- AKSHE;
- Operatorët ekonomikë;
- Institucionet bashkëpunuese;
- Qytetarët (indirekt).

Ndikimi sipas grupeve të prekura

Ministria e Mbrojtjes. Ndryshimi nuk krijon struktura të reja dhe nuk sjell detyra të reja mbikëqyrëse ndaj operatorëve. Detyrat shtesë janë të kufizuara dhe kryesisht koordinuese: hartimi dhe propozimi i VKM-së për tarifat, koordinimi me Ministrinë e Financave dhe shqyrtimi i raportit vjetor të monitorimit nga AKSHE. Këto detyra kryhen me stafin ekzistues.

AKSHE. Ndikimi kryesor është në organizimin e punës dhe procedurat: (i) përditësimi i procedurës së trajtimit të aplikimeve me hapin e verifikimit të pagesës para shqyrtimit të dosjes; (ii) arkëtimi kryhet nëpërmjet bankës/e-Albania në llogarinë e Thesarit, prandaj AKSHE nuk administron drejtpërdrejt të ardhurat, por verifikon dhe regjistron pagesat; (iii) mbajtja e regjistrit të pagesave dhe rakordimi periodik me Thesarin; (iv) llogaritja vjetore e kostove dhe raportimi. Këto kërkojnë caktimin e përgjegjësisë brenda strukturës ekzistuese dhe trajnim të stafit, por jo punonjës shtesë.

Institucionet bashkëpunuese. Procesi i koordinimit dhe verifikimit të aplikimeve me institucionet e tjera nuk ndryshon, pasi tarifa nuk prek kriteret apo afatet e shqyrtimit. Ministria e Financave/Thesari ka vetëm detyrën e regjistrimit të të ardhurave në buxhet.

Qytetarët. Ndryshimi i regjimit tarifor nuk ndryshon standardet e kontrollit apo kërkesat e sigurisë për artikujt piroteknikë, prandaj nuk pritet përmirësim i drejtpërdrejtë i sigurisë publike. Një ndikim pozitiv indirekt mund të ketë vetëm nëse burimet e kursyera nga buxheti i AKSHE-së ridrejtohen te inspektimi dhe monitorimi; ky ndikim vlerësohet i kufizuar dhe nuk merret si përfitim i matshëm i nismës.

Ndikimet e drejtpërdrejta

Për administratën publike

Pozitive:

- krijohet baza ligjore për tarifat;
- përmirësohet siguria juridike;
- mundësohet mbulimi i kostove administrative.

Negativ:

- nevojitet hartimi dhe monitorimi i sistemit tarifor.

Kosto dhe të ardhura për qeverinë:

- personeli i angazhuar: 18 punonjës për dosje, rreth 1 orë secili (supozim orientues);
- kostoja orientuese mesatare direkte për aplikim: 14 900 lekë; kostoja aktuale vjetore e administrimit: rreth 183 270 lekë (12,3 dosje/vit). Kostoja ndryshon sipas kategorisë së shërbimit (shih "Kostoja sipas kategorive të shërbimit");
- të ardhurat e mundshme nga tarifat, nëse tarifa mbulon 100% të kostos direkte: rreth 183 270 lekë/vit;
- tarifa synon mbulimin 100% të kostos direkte; kostot indirekte (mbikëqyrja pas lëshimit, shpenzimet e përgjithshme) nuk përfshihen në këtë përllogaritje;
- ndikimi mbi buxhetin: të ardhurat derdhen në Buxhetin e Shtetit; projektligji nuk krijon kosto shtesë, pasi zbatohet me stafin ekzistues.

Për operatorët ekonomikë

Pozitive:

- transparencë dhe parashikueshmëri e shtuar;
- qartësi juridike.

Negativ:

- pagesa e tarifave të aplikimit;
- rritje e kostove financiare të procedurës.

Kosto për bizneset:

- operatorë të prekur: 4; aplikime mesatare: 12.3 në vit;
- tarifa aktuale: 0 lekë (që nga viti 2021); tarifa e propozuar orientuese: deri në rreth 14 900 lekë për aplikim, në varësi të llojit (do të përcaktohet me VKM);
- kostoja vjetore për një operator = numri i aplikimeve të tij × tarifa (p.sh. 1 aplikim – 14 900 lekë; 2 aplikime – 29 800 lekë);
- kostoja vjetore totale për bizneset: rreth 183 270 lekë (12,3 × 14 900 lekë);
- tarifa është proporcionale me koston e shërbimit, pasi llogaritet mbi burimet e angazhuara për trajtimin e dosjes dhe nuk e tejkalon atë.

Ndikimi mbi ndërmarrjet e vogla dhe të mesme

Nga 4 subjekte aktive në fushën e artikujve piroteknikë, 1 është NVM. Me rreth 12,3 aplikime në vit dhe 4 subjekte, një operator paraqet mesatarisht rreth 3 aplikime në vit, me një kosto shtesë orientuese prej rreth 45 800 lekësh/vit. Kostoja e shqyrtimit të një dosjeje nuk varet nga madhësia e subjektit; për këtë arsye një tarifë e bazuar në kosto, e njëjtë për të njëjtin lloj procedure, konsiderohet proporcionale. Rreziku i disproporcionalitetit vlerësohet i ulët.

Ndikimet jo të drejtpërdrejta

Ndikimi indirekt tek qytetarët vlerësohet i kufizuar (shih "Ndikimi sipas grupeve të prekura"). Ndikimet e mundshme jo të drejtpërdrejta janë:

- rritje e cilësisë së administrimit të sistemit të licencimit;
- përmirësim i mbikëqyrjes së veprimtarive që lidhen me artikujt piroteknikë;
- forcim i sigurisë publike.

Përllogaritja orientuese e kostos administrative

Tarifat konkrete nuk janë përcaktuar ende dhe do të miratohen me VKM pas hyrjes në fuqi të ligjit. Për këtë arsye, kostoja financiare për bizneset nuk mund të përcaktohet përfundimisht në këtë fazë. Për analizën e volumit administrativ përdoret mesatarja 2021–2026 prej 12.3 licencash/autorizimesh të lëshuara në vit. Përllogaritja orientuese e kostos direkte për një licencë/autorizim është 14 900 lekë, e përbërë nga 14 400 lekë kosto pune dhe 500 lekë printim. Koha për verifikimin dhe arkivimin konsiderohet e përfshirë në angazhimin e 18 punonjësve. Për 12.3 licenca/autorizime në vit, kostoja orientuese vjetore është 12.3 × 14 900 lekë.

Kostoja sipas kategorive të shërbimit

Kostoja prej 14 900 lekësh është kosto mesatare orientuese për dosje dhe nuk supozohet e njëjtë për të gjitha shërbimet. Licencat e prodhimit kërkojnë vlerësim të kushteve teknike dhe të sigurisë së objektit, inspektim në vend dhe koordinim me disa institucione, prandaj kanë kosto më të lartë se mesatarja. Licencat e importit/eksportit kanë kompleksitet të mesëm, ndërsa autorizimet e importit/eksportit dhe të transitit jepen për çdo operacion, me dokumentacion më të kufizuar, dhe kanë kosto më të ulët se mesatarja. Numri i akteve dhe kostoja orientuese për secilën kategori jepen në tabelën e seksionit "Evidencat".
Për këtë arsye institucioni nuk propozon një tarifë të njëjtë për të gjitha shërbimet. Në përputhje me nën-opsionin 1B, tarifat do të diferencohen me VKM sipas kategorisë së shërbimit, mbi bazën e kostos së llogaritur për secilën kategori sipas metodologjisë së miratuar. Edhe regjimi i mëparshëm ishte i diferencuar (10 000 lekë për licencën e importit/eksportit dhe 1 000 000 lekë për licencën e prodhimit).

Vlerësimi financiar

- **Të ardhurat e pritshme (bruto) për buxhetin:** 12.3 aplikime × 14 900 lekë = 183 270 lekë/vit; në vitin e parë, duke supozuar hyrjen në fuqi të VKM-së brenda 6 muajve, rreth gjysma e kësaj shume.
- **Kostoja për bizneset në vazhdimësi:** e barabartë me të ardhurat e mësipërme, pasi tarifa paguhet nga operatorët.
- **Kostot shtesë të administrimit:** nuk parashikohen kosto shtesë të rëndësishme; hartimi i VKM-së dhe përshtatja e procedurave kryhen me stafin ekzistues .
- **Efekti neto:** tarifa përbën transferim nga operatorët te buxheti, prandaj VAN-i i Opsionit 1 rezulton zero (Shtojca 2/a); përfitimet kryesore – siguria juridike, transparenca dhe ndalimi i subvencionimit të shërbimit – janë jo-monetare.
- **Opsioni 0 dhe Opsioni 2:** nuk krijojnë kosto apo të ardhura shtesë, por ruajnë koston e pambuluar prej rreth 183 270 lekë/vit për buxhetin.

Kufizimet e analizës

- **Periudha e të dhënave:** 2021 –2026; viti 2026 është i pjesshëm.
- **Burimi:** regjistrat administrativë të AKSHE-së për licencat dhe autorizimet e lëshuara.
- **Numri i aplikimeve:** 74 akte të lëshuara;
- **Të dhënat financiare:** kostoja për dosje (14 900 lekë) është e vlerësuar, jo faktike; ajo bazohet në supozime ilustruese (1 orë/punonjës, 800 lekë/orë, 100 faqe, 5 lekë/faqe) dhe nuk përfshin kostot indirekte.
- **Tarifat e propozuara** nuk janë përcaktuar ende; ato do të miratohen me VKM, prandaj vlerat monetare janë orientuese dhe do të rishikohen gjatë hartimit të VKM-së.

Përmbledhja e vlerësimit

Opsioni 1 rezulton alternativa më efektive dhe proporcionale, pasi adreson drejtpërdrejt problemin e identifikuar, garanton siguri juridike dhe mundëson krijimin e sistemit tarifor pa ndryshuar procedurat ekzistuese të licencimit.

Përllogaritja e kostos për një licencë/autorizim

Shembull numerik orientues i kostos për një licencë/autorizim: Në praktikën e AKSHE-së, në shqyrtimin e një dosjeje angazhohen 18 punonjës. Dosja paraqitet elektronikisht nëpërmjet e-Albania dhe, për nevoja të shqyrtimit administrativ, dokumentacioni printohet. Për ilustrim, nëse secili punonjës angazhohet mesatarisht 1 orë për dosje dhe kostoja mesatare e një ore pune merret hipotetikisht 800 lekë, kostoja e punës është 18 × 1 × 800 = 14 400 lekë. Në këtë angazhim përfshihen edhe veprimet e verifikimit administrativ dhe arkivimit. Nëse një dosje ka 100 faqe dhe printimi merret orientueshëm 5 lekë për faqe, kostoja e printimit është 500 lekë. Kostoja totale orientuese direkte është 14 900 lekë për licencë/autorizim dhe, për 12,3 licenca/autorizime, 183 270 lekë në vit.

Zëri i kostos	**Përllogaritja orientuese**	**Kosto për 1 licencë/autorizim**	Kosto vjetore (12,3 licenca/autorizime)
Kosto e punës për shqyrtimin e dosjes, përfshirë verifikimin dhe arkivimin	18 punonjës × 1 orë × 800 lekë/orë	14 400 lekë	177 120 lekë
Printimi i dosjes nga e-Albania	100 faqe × 5 lekë/faqe	500 lekë	6 150 lekë
TOTALI ORIENTUES DIREKT	**Punë + printim**	**14 900 lekë**	183 270 lekë

Shënim: Vlerat 1 orë/punonjës, 800 lekë/orë, 100 faqe dhe 5 lekë/faqe janë supozime ilustruese. Verifikimi administrativ dhe arkivimi janë konsideruar pjesë e kohës së punës së punonjësve dhe nuk janë llogaritur si zëra shtesë. Kostoja totale orientuese direkte është 14 900 lekë për licencë/autorizim dhe 12.3 × 14 900 lekë në vit për 12.3 licenca/autorizime.
Analiza bazohet në të dhënat faktike administrative të AKSHE-së për periudhën 2021–2026.
Megjithëse disponohen të dhënat për numrin e licencave dhe autorizimeve të lëshuara, tarifat që do të aplikohen nuk janë përcaktuar ende. Për këtë arsye nuk është e mundur të llogariten me saktësi kostot dhe përfitimet financiare për operatorët ekonomikë.

Arsyetimi i opsionit të preferuar

- *Zgjidhni opsionin e preferuar, bazuar në analizë.*
- *Shpjegoni arsyetimin tuaj.*

Opsioni 1 është alternativa më efektive, proporcionale dhe juridikisht e qëndrueshme, pasi eliminon boshllëkun ligjor dhe krijon bazën e nevojshme për vendosjen e tarifave pa ndryshuar procedurat ekzistuese të licencimit dhe autorizimit.

Analiza me shumë kritere

Secili opsion është vlerësuar me pikë nga 1 (shumë dobët) deri në 5 (shumë mirë) për çdo kriter; në kllapa jepet pika e shumëzuar me peshën. Peshat e kritereve mblidhen në 20, prandaj totali maksimal është 100 pikë.

Kriteri	Pesha	Opsioni 0	Opsioni 1	Opsioni 2
Siguria juridike dhe eliminimi i boshllëkut ligjor	5	1 (5)	5 (25)	1 (5)
Efikasiteti i mekanizmave për mbulimin e kostove administrative	4	1 (4)	4 (16)	2 (8)
Efikasiteti në transparencë dhe parashikueshmëri	4	1 (4)	5 (20)	2 (8)
Lehtësia e zbatimit institucional	3	1 (3)	3 (9)	2 (6)
Kosto-efektiviteti për buxhetin		1 (4)	4 (16)	2 (8)
Totali (maksimumi 100)		20	86	35

Opsioni 1 merr 86 nga 100 pikë, ndërsa Opsioni 2 merr 35 dhe Opsioni 0 merr 20. Opsioni 1 është i vetmi që krijon bazën ligjore dhe mundëson mbulimin e kostove; vlerësohet më ulët vetëm për lehtësinë e zbatimit, pasi kërkon metodologji, VKM dhe mekanizëm arkëtimi. Opsioni 2 përmirëson pak transparencën, por, ashtu si Opsioni 0, nuk e zgjidh problemin dhe ruan koston e pambuluar prej rreth 183 270 lekë/vit për buxhetin. Ndikimi mbi operatorët nuk është përdorur si kriter, por është analizuar veçmas në seksionin e ndikimeve: kostoja për ta kufizohet në koston e shërbimit dhe për rrjedhojë është proporcionale. Brenda Opsionit 1, modeli 1B + 1D (tarifë e diferencuar, e bazuar në koston direkte) ofron ekuilibrin më të mirë ndërmjet mbulimit të kostos dhe proporcionalitetit.

Krahasuar me opsionin 0 dhe opsionin 2:

- eliminon boshllëkun ligjor;
- krijon bazën ligjore të nevojshme për tarifat;
- garanton transparencë dhe siguri juridike;
- nuk kërkon ngritje strukturash të reja;
- përbën instrumentin minimal të nevojshëm për zgjidhjen e problemit.

Nëse ligji nr.73/2021 mbetet i pandryshuar, AKSHE do të vazhdojë të administrojë procedurat e licencimit dhe autorizimit pa bazë ligjore për aplikimin e tarifave. Si rezultat do të vazhdojë:

- pamundësia e mbulimit të kostove administrative;
- mungesa e një sistemi tarifor transparent;
- pasiguria juridike mbi financimin e këtyre procedurave;
- nevoja për financimin e plotë të procesit vetëm nga burimet buxhetore ekzistuese.

Projektligji nuk sjell kosto shtesë buxhetore për shtetin. Përkundrazi, krijon bazën ligjore për miratimin e tarifave administrative, të cilat mund të kontribuojnë në mbulimin e një pjese të kostove të procesit të licencimit dhe autorizimit.

Megjithëse krijon barrë financiare për operatorët ekonomikë, kjo barrë do të përcaktohet mbi bazën e kostove reale administrative dhe në përputhje me parimin e proporcionalitetit.

Çështje të zbatimit

- *Shpjegoni se cila njësi do të jetë përgjegjëse për zbatimin e opsionit të zgjedhur.*

- *Shpjegoni pengesat e mundshme për zbatimin e opsionit të zgjedhur.*
- *Përshkruani masat që do të ndërmerren gjatë zbatimit për të arritur qëllimet e politikës.*
- *Specifikoni të gjitha kërkesat e përputhshmërisë dhe të zbatimit.*

Strukturat përgjegjëse

AKSHE është përgjegjëse për zbatimin e dispozitave të reja, administrimin e aplikimeve për licenca/autorizime, përllogaritjen e kostove administrative dhe përgatitjen e metodologjisë për përcaktimin e tarifave, si dhe të dokumentacionit teknik mbështetës për projektvendimin e Këshillit të Ministrave. Gjithashtu, AKSHE ndjek zbatimin e sistemit tarifor, monitoron aplikimin e tarifave dhe siguron publikimin e tyre në faqen zyrtare dhe në platformën e-Albania.

Ministria e Mbrojtjes është përgjegjëse për koordinimin e hartimit të projektvendimit të Këshillit të Ministrave, në bashkëpunim me AKSHE-në dhe institucionet e tjera përkatëse, si dhe për ndjekjen e procedurave për paraqitjen dhe miratimin e tij brenda afatit të parashikuar.

Ministria e Financave është përgjegjëse për dhënien e mendimit mbi projektvendimin, veçanërisht lidhur me metodologjinë e përllogaritjes së tarifave dhe mënyrën e administrimit dhe arkëtimit të të ardhurave.

Zbatimi i këtyre detyrave parashikohet të realizohet nëpërmjet strukturave dhe burimeve njerëzore ekzistuese, pa qenë e nevojshme krijimi i strukturave të reja apo shtimi i personelit.

Varësia ndërmjet ligjit dhe aktit nënligjor

Tarifat mund të aplikohen vetëm pas miratimit dhe hyrjes në fuqi të vendimit të Këshillit të Ministrave që përcakton masën e tyre. Deri në atë moment, aplikimet për licenca/autorizime vijojnë të trajtohen pa tarifë. Për rrjedhojë, miratimi dhe hyrja në fuqi e këtij vendimi përbëjnë masën e parë të zbatimit të ndryshimeve ligjore.

Pengesat e mundshme

Pengesat e mundshme në zbatimin e projektligjit lidhen me vonesat në hartimin dhe miratimin e vendimit të Këshillit të Ministrave, mungesën e të dhënave të plota për përcaktimin e kostove reale administrative të shërbimeve, si dhe mundësinë e kundërshtimeve nga operatorët ekonomikë lidhur me nivelin e tarifave të propozuara.

Një tjetër pengesë mund të jetë përcaktimi i tarifave në nivele që nuk pasqyrojnë kostot reale të trajtimit të aplikimeve. Gjithashtu, mund të evidentohen vështirësi teknike dhe administrative në organizimin e mekanizmit të pagesës dhe arkëtimit të tarifave, përfshirë integrimin me platformën e-Albania dhe verifikimin e kryerjes së pagesës përpara shqyrtimit të aplikimit.

Masat për adresimin e pengesave dhe garantimin e zbatimit

Për të siguruar zbatimin efektiv të ndryshimeve ligjore, parashikohen këto masa:

- Hartimi dhe miratimi i vendimit të Këshillit të Ministrave për përcaktimin e tarifave brenda afatit të parashikuar;
- Përgatitja e një metodologjie për llogaritjen e tarifave, të mbështetur në kostot administrative reale dhe të dokumentuara për çdo kategori shërbimi;
- Përditësimi i procedurave administrative të AKSHE-së, me qëllim përfshirjen e procesit të pagesës dhe verifikimit të saj në trajtimin e aplikimeve;
- Krijimi dhe funksionalizimi i mekanizmit të pagesës dhe arkëtimit elektronik, përfshirë integrimin me platformën e-Albania, përpara fillimit të aplikimit të tarifave;
- Publikimi i tarifave dhe i informacionit mbi mënyrën e pagesës në faqen zyrtare dhe në platformën e-Albania;
- Informimi paraprak i operatorëve ekonomikë për tarifat e miratuara dhe procedurat e pagesës;
- Monitorimi i zbatimit të sistemit tarifor dhe rishikimi periodik i tarifave, në përputhje me kostot administrative të verifikuara.

Faza e shqyrtimit/vlerësimit

- *Jepni një përshkrim të përmbledhur të masave të monitorimit dhe të vlerësimit.*
- *Identifikoni kriteret/treguesit për të matur arritjen e qëllimeve ose progresin drejt tyre.*

-

Institucioni përgjegjës për monitorimin: AKSHE – mbledh të dhënat për aplikimet, tarifat e arkëtuara dhe kostot administrative të shërbimeve, mat treguesit dhe përgatit raportin vjetor të monitorimit.
Institucioni raportues: Ministria e Mbrojtjes – shqyrton raportin e AKSHE-së dhe raporton për arritjen e objektivave të projektligjit në kuadër të raportimit vjetor të ministrisë.
Mekanizmat dhe masat e monitorimit:

- regjistri elektronik i aplikimeve dhe i pagesave në AKSHE;
- rakordimi periodik i arkëtimeve me Thesarin;
- llogaritja vjetore e kostos së shërbimeve sipas metodologjisë së miratuar;
- raporti vjetor i monitorimit nga AKSHE drejt Ministrisë së Mbrojtjes;
- vlerësimi ex-post pas 3 vitesh zbatimi dhe, sipas nevojës, rishikimi i tarifave me VKM.

Treguesit e mëposhtëm matin rezultatet e politikës (jo masat e zbatimit, si miratimi i VKM-së):

Treguesi	***Vlera bazë***	***Objektivi***	***Afati***	***Burimi***
Përqindja e kostove administrative të shërbimeve të licencimit dhe autorizimit që mbulohen nga të ardhurat e arkëtuara prej tarifave	0%	≥ 90% në vitin e parë të zbatimit; 100% e kostos direkte nga viti i dytë	Viti 1–3	AKSHE / Thesari
Kostoja neto për buxhetin e AKSHE-së për shërbimet e licencimit dhe autorizimit (lekë/vit)	≈ 183 270 lekë	≈ 0 lekë nga viti i dytë	Viti 1–3	AKSHE
Përqindja e aplikimeve për licenca/autorizime për të cilat është arkëtuar tarifa sipas regjimit të ri	0%	100%	Viti 1	AKSHE
Përqindja e tarifave të publikuara dhe të zbatuara sipas metodologjisë së miratuar, për të gjitha kategoritë e shërbimit	0%	100%	Viti 1	AKSHE / MM

Tabela: Vlera aktuale neto në total (VAN) - kostot dhe përfitimet me vlerë monetare të përcaktuar në milionë lekë e zbritur për 10 vjet (Vlera aktuale e kostos dhe vlera aktuale e përfitimit); krahasuar me status quo-në.

	Viti 1	**Viti 2**	**Viti 3**	**Viti 4**	**Viti 5**	**Viti 6**	**Viti 7**	**Viti 8**	**Viti 9**	**Viti 10**
Faktori zbritës	1.00	0.95	0.91	0.87	0.82	0.79	0.75	0.71	0.68	0.65
Kosto për buxhetin - një herë	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Kosto për buxhetin - në vazhdimësi	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Kosto për bizneset - një herë	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Kosto për bizneset - në vazhdimësi	0,09	0,18	0,18	0,18	0,18	0,18	0,18	0,18	0,18	0,18
Kosto për grupet e tjera - një herë	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Kosto për grupet e tjera - në vazhdimësi	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Kosto në total	0,09	0,18	0,18	0,18	0,18	0,18	0,18	0,18	0,18	0,18
Kosto e zbritur= Kosto në total x Faktori zbritës	0,09	0,17	0,17	0,16	0,15	0,14	0,14	0,13	0,12	0,12
Përfitimet për buxhetin – një herë	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Përfitimet për buxhetin – në vazhdimësi	0,09	0,18	0,18	0,18	0,18	0,18	0,18	0,18	0,18	0,18
Përfitimet për grupet e tjera – një herë	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Përfitimet për grupet e tjera – në vazhdimësi	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Përfitimet për biznesin – një herë	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Përfitimet për biznesin – në vazhdimësi	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0

Përfitimet totale	0,09	0,18	0,18	0,18	0,18	0,18	0,18	0,18	0,18	0,18
Përfitimi i zbritur= Përfitimi në total x faktori zbritës	0,09	0,17	0,17	0,16	0,15	0,14	0,14	0,13	0,12	0,12
Vlera prezente aktuale e përfitimit në total										1,40
Vlera prezente aktuale e kostos në total										1,40
Vlera Prezente Neto Aktuale (VAN) = Vlera aktuale e përfitimit në total – Vlera aktuale e kostos në total										0,00

Shënim: Vlerat janë në milionë lekë. Kosto për bizneset dhe përfitimi për buxhetin në vit = 12.3 aplikime × 0,0149 mln lekë (në vitin e parë gjysma, me supozimin se VKM-ja hyn në fuqi në mes të vitit). Vlera aktuale për 10 vjet ≈ 12.3 × 0,114 mln lekë. Tarifa përbën transferim nga bizneset te buxheti, prandaj VAN = 0; përfitimet jo-monetare (siguria juridike, transparenca) nuk janë kuantifikuar.

Raporti i vlerësimit të ndikimit - Shtojca 2/b

Tabelë: Vlera aktuale neto në total e çdo opsioni

Opsioni	Vlera aktuale në milionë lekë		Vlera aktuale neto në milionë lekë
	Kosto	Përfitimi	
Opsioni 1	1,40	1,40	0,00
Opsioni 2	0	0	0

MINISTËR

Ermal NUFI